

Nr. 864 prot.

Tiranë, 20 / 05 /2025

Nr. 1464 prot.

Tiranë, 20 / 05 /2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

**INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**DHE**

**AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Në vazhdim të referuara si “**Palë**”,

## **Preambul**

Palët e kësaj marrëveshjeje,

- ❖ **Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)**, ose emërtuar ndryshe si struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e punës, si institucion qendror publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punën, ka për mision ushtrimin e kontrollit, konstatimit, këshillimit, njoftimit, formimit, zbutjes së konflikteve, parandalimit dhe sanksionimit në kuadër të respektimit të kërkesave ligjore, sipas legjislacionit të punës.
- ❖ **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**, është organ i pavarur, që rregullon veprimtarinë në fushën e transmetimeve audiovizive lineare, transmetimeve audiovizive jolineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- ❖ Kuptojnë qartë përgjegjësitë e tyre institucionale për të nxitur dhe synuar një mjedis mediatik më të sigurt për punën e gazetarëve dhe të punonjësve në tërësi në këtë sektor, si dhe më transparent, duke përmbyshur një nga kushtet kyçe për anëtarësimin në BE.
- ❖ Vlerësojnë se dinjiteti, siguria ekonomike si dhe rëndësia e një kulture pune, bazuar në respektin dhe dinjitetin e ndërsjelltë për të parandaluar diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin në mjedisin e punës, janë domosdoshmëri për një mjedis miqësor pune dhe se shkelja e kushteve të punës të të punësuarve në këtë sektor janë një kërcënim për lirinë e shprehjes dhe janë të papranueshme dhe të papajtueshme me punën e denjë;
- ❖ Janë të bindura dhe pranojnë se siguria e kufizuar në punë dhe kushtet e papërshtatshme të punës për gazetarët përbëjnë sfida serioze përsa i përket vetëcensurës, presionit nga aktorët të ndryshëm dhe një rezistencë të reduktuar ndaj dezinformimit, arsye për të cilën konsiderohet si një fushë që paraqet rrezik të mesëm në këtë drejtim;
- ❖ Besojnë se angazhimi i të gjitha palëve të interesuara, përfshirë institucionet shtetërore, median, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare, është thelbësor për të siguruar një mjedis mediatik të lirë, të pavarur dhe profesional.
- ❖ Vlerësojnë se në mënyrë që Shqipëria të përafrohet me standardet e BE-së dhe të sigurojë një peizazh mediatik të lirë e të përgjegjshëm, duhen ndërmarrë masa konkrete:

Nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e ndërveprimit mes palëve në fushat me interes të përbashkët për një funksionim sa më efektiv dhe pëmirësimin e veprimtarisë së institucioneve për garantimin e zbatimit të dispozitave ligjore për kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimin dhe mirëqënien në sektorin e mediave audiovizive, si dhe forcimin e monitorimit të marrëdhënieve të punës në këtë sektor.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekt i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve mes dy palëve për sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit në kuadër të marrjes së masave për kushte të denja pune në sektorin e mediave audiovizive.

## **Neni 3**

### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në bazën ligjore si më poshtë vijon:

- ☐ *Kushtetuta e RSH;*
- ☐ *Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (Ligji 7961/1995, i ndryshuar);*
- ☐ *Ligji "Për inspektimin e punës" (Ligji nr.9634/2006 i ndryshuar);*
- ☐ *Ligji "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" (Ligji Nr. 10 237/18.2.2010, i ndryshuar);*
- ☐ *Ligji "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë (Ligji nr. 99/2024);*
- ☐ *Ligji "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"( Ligjit nr. 97/2013 ", i ndryshuar);*
- ☐ *I gjithë legjislacioni i punës.*

## **Neni 4**

### **Fushat e përbashkëta të përgjegjësisë**

1. AMA dhe ISHPSHSH do të bashkëpunojnë në zbatim të ligjeve respektive, për vlerësimin/hartimin e akteve nënligjore, rregulloreve dhe udhëzuesve, ose/dhe nismave apo mekanizmave lidhur me mbrojtjen e punëmarrësve të punësuar në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.
2. AMA dhe ISHPSHSH do të bashkëpunojnë dhe do të shkëmbejnë informacion në fushën e punës për të dhëna që secila palë disponon.
3. Të dy palët do të bashkëpunojnë për të identifikuar, adresuar, trajtuar, çështje ligjore dhe teknike që lidhen me marrëdhëniet e punës të punonjësve të medias.



## **Neni 5**

### **Angazhimet e Palëve**

#### **1. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) angazhohet:**

- a. Të bashkëpunojë me Inspektoratin e Punës për të ofruar asistencë në ndërmarrjen e masave që synojnë përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e medias.
- b. Të mbështesë nisma për edukimin dhe informimin e punëdhënësve dhe punonjësve të medias lidhur me të drejtat dhe detyrimet që u takojnë sipas legjislacionit të punës.
- c. Të sigurojë informacion mbi subjektet që kryejnë aktivitet mediatik sipas parashikimeve në nenin 7.

#### **2. Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) angazhohet:**

- a. Të zhvillojë inspektime të bazuara në risk, me qëllim sigurimin që kushtet e punës, kontratat individuale të punës dhe marrëdhëniet e punës në tërësi për punonjësit e medias të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të respektohen në mënyrë të plotë nga punëdhënësit.
- b. Të trajtojë dhe të kontribuojë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesave që mund të lindin nga marrëdhëniet e punës së punonjësve të medias, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- c. Të informojë dhe të ndërgjegjësojë punëdhënësit dhe punëmarrësit në sektorin e medias mbi të drejtat dhe detyrimet që u takojnë sipas legjislacionit të punës.
- d. Të sigurojë dhe të vërë në dispozicion të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) informacion të plotë, të verifikuar dhe të saktë mbi të dhënat që rezultojnë nga kontrolllet e kryera.

## **Neni 6**

### **Bashkëpunimi me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin**

Palët e kësaj marrëveshjeje angazhohen të bashkëpunojnë për ndërmarrjen e masave me qëllim rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin në sektorin e mediave audiovizive, në funksion të zbatimit të dispozitave ligjore që lidhen me kushtet e punës, mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, pagat, sigurimet dhe mirëqenien në punë. Bashkëpunimi ndërmjet palëve, pa u kufizuar, do të përfshijë:

1. Organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere, përfshirë tryeza të përbashkëta pune me stafet respektive dhe me pjesëmarrjen e aktorëve të tjerë të interesuar, me fokus rolin dhe detyrimet e secilit institucion në sektorin e mediave audiovizive, si dhe të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni i punës.
2. Palët do të informojnë dhe ftojnë reciprokisht njëra-tjetrën për pjesëmarrje në workshope, seminare dhe konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare, në tema me interes të përbashkët.

3. Palët angazhohen të hartojnë, miratojnë dhe shpërndajnë materiale informuese (broshura, video, etj.), të përgatitura nga vetë institucionet ose aktorë të tjerë bashkëpunues. Këto materiale do të shpërndahen gjatë inspektimeve apo aktiviteteve ndërgjegjësuere, dhe sipas rastit, do të publikohen në faqet zyrtare të institucioneve respektive dhe/ose në kanale të tjera komunikimi publik.

## **Neni 7**

### **Ndërveprimi institucional për shkëmbimin e informacionit**

Palët angazhohen të bashkëpunojnë në mënyrë aktive për shkëmbimin e informacionit të ndërsjellë, në fushat me interes të përbashkët, me qëllim rritjen e efektivitetit institucional dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit në sektorin e mediave audiovizive dhe të marrëdhënieve të punës. Pa u kufizuar, ky bashkëpunim përfshin:

1. Shkëmbimin në mënyrë efikase dhe pa vonesa burokratike të informacionit të nevojshëm, përfshirë:

- a) Një përshkrim të përgjithshëm të sektorit të medias, duke identifikuar llojet e mediave, strukturat, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse;
- b) Listimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitete në fushën mediatike.

2. Ky shkëmbim do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë ligjin për inspektimin e punës dhe legjislacionin përkatës në fushën e mediave audiovizive, Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij memorandum.

3. Proçesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për atë sa e lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetin në përsheptimin e kohës së shkëmbimit të informacionit si dhe vullnetit të mirë për vënien në dispozicion të të dhënave të disponueshme në mënyrë të rregullt dhe konform kuadrit ligjor.

## **Neni 8**

### **Ndërveprimi institucional me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor**

Palët e kësaj marrëveshjeje angazhohen të fuqizojnë bashkëpunimin në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator institucional, me qëllim rritjen e efektivitetit në zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës në sektorin e mediave audiovizive.

Pa u kufizuar, bashkëpunimi në këtë drejtim përfshin:

- Organizimin e takimeve periodike me sindikatat, përfaqësuesit e punëmarrësve dhe punëdhënësve, me qëllim vlerësimin dhe propozimin e nevojës për ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullator, që synojnë forcimin e zbatueshmërisë së të drejtave të punës dhe përmirësimin e kushteve të punës në këtë sektor.



## **Neni 9**

### **Koherenca e takimeve ndërmjet palëve**

Titullarët e institucioneve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje angazhohen të zhvillojnë takime periodike çdo 6 muaj, me qëllim rishikimin dhe vlerësimin e përparimit të arritur në zbatimin e objektivave të memorandumit. Gjatë këtyre takimeve, palët do të identifikojnë dhe përditësojnë masat e nevojshme, në funksion të përmirësimit të bashkëpunimit, vendosjes së prioriteteve dhe shkëmbimit të pikëpamjeve për çështje me interes të përbashkët. Qëllimi i këtij mekanizmi është të sigurojë një kornizë funksionale, të sigurt dhe efikase për zbatimin e ligjit në fushën e marrëdhënieve të punës në sektorin e mediave audiovizive.

## **Neni 10**

### **Protokolli i komunikimit mes palëve**

1. Palët e kësaj marrëveshjeje përcaktojnë, nëpërmjet shkëmbimit të shkresave, pikat respektive të kontaktit dhe protokollin e komunikimit mes tyre, brenda 10 ditëve nga dita e lidhjes së Marrëveshjes.
2. Palët do të njoftojnë menjëherë nëse ndryshohet personi i kontaktit.
3. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë dhe të zbatojnë çdo detyrim që rrjedh nga legjislacioni i fushës në fuqi mbi konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave të dokumentave dhe informacioneve të tjera të shkëmbyera mes tyre.

## **Neni 11**

### **Marrëveshja dhe ndryshimet**

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të paraqitur me shkrim.
3. Çdo shtesë a ndryshim i saj do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të fillojë efektet juridike vetëm pas nënshkrimit nga palët.
4. Asnjë ndryshim tjetër i marrëveshjes nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë t'i referohet shprehimisht marrëveshjes dhe të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i palëve.

**Neni 12**  
**Dispozitat e fundit**

1. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat 1-vjeçar.
2. Në rast të ndryshimit të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse.
3. Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.
4. Në rast mosmarrëveshje të dyja palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.
5. Me miratimin e kësaj marrëveshjeje, shfuqizohet marrëveshja e bashkëpunimit e lidhur ndërmjet palëve me datë 28.02.2019 dhe nr.458 prot.,(për ISHPSHSH-në) dhe nr.1031 prot (për AMA)
6. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe 2 (dy) të tjera pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 20.05. 2025.

**PËR**

**AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**KRYETARI**

**Armela KRASNIQI**



**PËR**

**INSPEKTORATIN SHTETËROR TË PUNËS  
DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

**KRYEINSPEKTORI**

**Eljo MUÇAJ**

